

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private dhe monitorimi në distancë”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** shërbime roje/ shërbime me roje 79713000-5

**VLERA E FONDIT LIMIT: 48.598.436 (dyzet e tetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lek, pa TVSH.**

Vlera e fondit Limit në monedhën nderkombetare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 482.989,82 (katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë presje tetëdhjetë e dy) euro.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankës të Shqipërisë datë 28.05.2024 është 100.62 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; përkatësisht në vlerën: 971.968,72 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje shtatëdhjetë e dy) lekë dhe në monedhën euro sipas kursit të këmbimit datë 28.05.2024 është 9659,80 (nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë presje tetëdhjetë) euro të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për*

*miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”*

*“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”*

## **2. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

### **2.1.1 Operatori ekonomik duhet te paraqesi certifikatat si me poshte vijon:**

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme);
- ISO/IEC 27001:2023 ose ekuivalente (e vlefshme);

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë). Çertifikata kërkohe të jetë e vlefshme për periudhën e zhvillimit të procedurës dhe të ketë lidhje me objektin e prokurimit. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik çertifikatat duhet të paraqiten të paktën nga njëri prej anëtarëve të bashkimit.

**Çertifikata e standardit të cilësisë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)** është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektorëve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohe nga AK për të vërtetuar cilësinë e shërbimit sipas standardeve ndërkombëtare, përmirësimin e vazhdueshëm të këtij shërbimi të ofruar nga operatorët ekonomik si dhe garantimin e realizimit në kohë dhe me sukses të objektit të kontratës.

**Çertifikata e menaxhimit të sigorisë së informacionit ISO 27001:2023 (ose ekuivalente)** është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigorisë së informacionit. Në raport me informacionin e administruar nga sistemi i kamerave gjykohe se ky informacion duhet mbrojtur nga Kontraktori. Sistemi i sigorisë së informacionit sa më sipër kërkuar, parandalon kapjen, fshirjen, modifikimin ose kopjimin e informacionit dhe rrjedhimisht dhe keqpërdorimin e tij. Çertifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve te OE ofertues dhe i jep sigurinë e nevojshme autoritetit kontraktor mbi sigurinë e informacionit që do të administrohet nga kamerat e vendosura në objekte.

**Argumentimi:** *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të*

prokurimit publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**2.1.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private në nënkategorinë ”1.3.A” lëshuar nga organi kompetent, konform ligjit nr. 75, date 10.07.2014 ”Per shërbimin privat të sigurisë fizike”.

**Argumentimi:** Kriteri është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4, gërma (a) të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, si dhe në mbështetje të ligjit nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, Neni 7 ”Kategoritë e licencës” ku specifikisht përcaktohet:

Licencat, sipas këtij ligji, ndahen në dy nënkategori:

a) nënkategoria I.3.A, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike”, i cili ushtrohet në të gjithë territorin e vendit;

Referuar specifikave të vendosura nga autoriteti kontraktor për këtë objekt prokurimi është përcaktuar licencë për ushtrimin e aktivitetit në nënkategorinë I.3.A.

**2.1.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimit publik Licencë të titullarit të Subjektit për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private në kategorinë ”1.3.A” me kohë të plotë lëshuar nga organi kompetent, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

**Argumentimi:** Kriteri është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma (a) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, si dhe në mbështetje të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, Neni 14 ”Kriteret për liçencim” ku specifikisht përcaktohet:

1.Për pajisjen me licencë të nënkategorisë I.3.A subjekti duhet të plotësojë këto kritere:

a) të jetë i regjistruar në QKR si sh.a. ose sh.p.k. dhe të ketë përcaktuar më parë drejtuesin teknik për këtë veprimtari;

b) **titullari i subjektit të jetë i pajisur me certifikatën e nënkategorisë I.3.A;**

c) drejtuesi teknik të jetë i pajisur me certifikatën e nënkategorisë I.3.A dhe të jetë me kohë të plotë pune;

ç) të ketë lidhur kontratë pune ndërmjet titullarit dhe drejtuesit teknik.

Referuar specifikave të vendosura nga autoriteti kontraktor për këtë objekt prokurimi është përcaktuar se për pajisjen me licencë të shoqërisë në nënkategorinë I.3.A. është e detyrueshme që titullari i subjektit të jetë i pajisur me certifikatë të nënkategorisë I.3.A.

**2.1.4** Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë çertifikatën e drejtuesit teknik, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A.

**Argumentimi:** Kriteri është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma (a) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, si dhe në mbështetje të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, Neni 14 “Kriteret për liçencim” ku specifikisht përcaktohet:

1.Për pajisjen me licencë të nënkategorisë I.3.A subjekti duhet të plotësojë këto kritere:

a) të jetë i regjistruar në QKR si sh.a. ose sh.p.k. dhe të ketë përcaktuar më parë drejtuesin teknik për këtë veprimtari;

b) titullari i subjektit të jetë i pajisur me çertifikatën e nënkategorisë I.3.A;

c) **drejtuesi teknik të jetë i pajisur me çertifikatën e nënkategorisë I.3.A dhe të jetë me kohë të plotë pune;**

ç) të ketë lidhur kontratë pune ndërmjet titullarit dhe drejtuesit teknik.

Referuar specifikave të vendosura nga autoriteti kontraktor për këtë objekt prokurimi është përcaktuar se për pajisjen me licensë të shoqërisë në nënkategorinë I.3.A. është e detyrueshme që titullari i subjektit të jetë i pajisur me çertifikatë të nënkategorisë I.3.A.

**2.1.5** Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat e punonjesve te sherbimit për jo më pak se 50 punonjës për nënkategorinë 1.3.A, konform Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, shoqeruar me listen emerore te punonjesve te sherbimit te punesuar të deklaruar ne DVP, Tirane (te vlefshme brenda 4 viteve) te nenshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori. Punonjesit e pasqyruar ne listen emerore te nenshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori duhet te figurojne ne listepagesat e sigurimeve shoqerore për 3 (tre) muajt e fundit Mars 2024-Maj 2024. Ne rast bashkimi te operatorëve ekonomik , kjo liste duhet të paraqitet në perputhje me perqindjen e marrë persiper në kontratën e bashkëpunimit.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet deklaramit të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues sa më sipër kërkuar, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Argumentim:** Kërkesat e mësipërme janë vendosur në mbështetje të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4 si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Neni 41 pika 4, germa (b). Në bazë të udhëzimit të brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018, për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, përcaktohet se numri minimal i punonjësve të shërbimit për një turn duhet të jetë me koeficientin 1.66, pra për një shërbim 24 orësh (3 turne) është 4.98 roje për vendroje.

Ne kërkojmë sigurimin fizik për 10 vendshërbime 24 orësh të cilat në total shkojnë 49.8 roje. Referuar përlllogaritjes është gjykuar i nevojshëm numri i punonjësve të shërbimit të çertifikuar me kategorinë I.3.A prej 50 (pesëdhjetë) punonjës.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të

jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 , pika 1 , pika 2 si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (a) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar: Kërkohet vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të këtij loti, referuar nenin 43 pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi kjo është një procedurë e **Hapur- mbi kufirin e lartë monetar**, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë 3(tre) viteve të fundit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomik duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese*. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika ”c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit**

**limit** dhe konkretisht jo më të vogël se vlera: **19.439.374,4 (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër presje katër) lekë pa tvsh** ose **193.195,9 (njëqind e nëntëdhjetë e tremijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë presje nëntë)** Euro ( Kursi i këmbimit referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë me datë 28.05.2024 është 100.62 lek). Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.*

**2.3.2** Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **60 (gjashtëdhjetë) punonjës** për periudhën **Mars 2024 – Maj 2024**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Mars 2024 – Maj 2024**.
- b. Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Mars 2024 – Maj 2024**.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/1 gërma c), neni 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 41 pika 4, gërma (c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.*

*Ky kriter është vendosur bazuar në numrin e vëndrojeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, numrit e rojeve që kërkon një objekt për tu ruajtur fizikisht bazuar në koeficientin (1.66 roje për turn) si dhe stafit drejtues dhe teknik të specifikuar në këto kritere.*

**2.3.3** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre ose punonjës të kontraktuar personel të kualifikuar/ certifikuar si më poshtë:

- 1(një) Inxhinier Elektronik, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome, kontratën e punës.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/1 gërma c), neni 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 41 pika 4, gërma ( b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.*

*Referuar objektit të prokurimit dhe termave të referencës të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, është kërkuar që për objektet në ruajtje të implementohet dhe monitorimi në distancë me kamera sigurie dhe me sisteme alarmi të cilat do të të integrohen në platformën monitoruese në sallën e autoritetit kontraktor në kuadër të rritjes së sigurisë në objekte duke patur parasysh se këto ambiente frekuentohen nga një numër i madh qytetarësh dhe nevojitet krijimi i një sigurie maksimale si për qytetarët ashtu dhe vetë ambientet.*

*Vendosja e këtij kriteri, është pjesë e domosdoshme dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës, pasi pajisjet do të montohen dhe integrohen në platformën ekzistuese, si dhe do të testohen nëse i kryejnë funksionet sipas specifikimeve teknike. Kjo e bën të domosdoshëm që operatori ekonomik të japë garanci se disponon staf teknik të specializuar për realizimin e termave të referencës për monitorimin në distancë me kamera dhe sisteme alarmi. Autoriteti Kontraktor do të rezervojë të drejtën të kryejë testimin e tyre në terren.*

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues për kamerat që do të vendosen në objekt duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 41, pika 6, nenin 44, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik zotëron kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson termat e referencës dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për zbatimin me korrektësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, vlerësohet e nevojshme që operatorët ekonomikë të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë me pajisjet e nevojshme për realizimin e kësaj procedure prokurimi. Duke qenë se pjesë e integruar e procedurës është dhe monitorimi me kamera të cilat do të instalohen, konfigurohen dhe testohen nga operatori ekonomik dhe nisur nga fakti që materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.*

*Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga shërbimet që parashikohen të realizohen si dhe për shkak të garantimit dhe rritjes së sigurisë në objekte duhet që kamerat që do të vendosen të jenë sipas standarteve më të mira dhe njëkohësisht të sigurohet autoriteti kontraktor që OE fitues potencial ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke vënë në dispozicion të realizimit të shërbimit brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci. Plotësimi i kërkesës më sipër garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.*

**2.3.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 2 punonjës të siguruar si staf teknik, kjo e vërtetuar me kodin përcaktuar në listpagesat për periudhën Mars 2024- Maj 2024, si dhe kontratën e punës respektive.

*Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

**Argumentimi:** *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm staf teknik referuar shërbimet që duhet të kryhet nga operatorët ekonomikë për monitorimin në distancë me kamera dhe sisteme alarmi në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 41 të VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, pika 4, germa (b) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”*

*Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimit. Sqarojmë se, stafi teknik është kërkuar në përputhje me termat e referencës ku kërkohet specifikisht që operatori ekonomik të kryejë krahas shërbimit me roje fizike dhe shërbimin e monitorimit në distancë duke instaluar kamera dhe sisteme alarmi të cilat do të integrohen në platformën monitoruese në sallën e autoritetit kontraktor. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që implementimi i pajisjeve dhe integrimi i tyre do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e tyre sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike dhe termat e referencës. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar kodi përkatës në listëpagesat për periudhën **Mars 2024- Maj 2024**, si dhe kontrata e punës respektive.*

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të ketë në staf ose të kontraktuar me kontratë pune të paktën 1(një) punonjës të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve të kamerave e vërtetuar me certifikatën përkatëse, kontratën e punës si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.

*Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK,*



*përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

**2.3.7** Operatori Ekonomik duhet të ketë në staf ose të kontraktuar me kontrate pune të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar nga kompania prodhuese të sistemeve të alarmit, e vërtetuar me çertifikatën përkatëse, kontratën e punës si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** *Në përshkrimin e termave të referencës vërejtje se në objektet në ruajtje do të vendosen sistemet e kamerave dhe të alarmit në mbështetje të shërbimit me roje fizike. Lidhur me vendosjen e sistemeve të mësipërme dhe integrimin e tyre, prodhuesit kanë ndërtuar programe trajnimi dhe kontrolli të shoqërive dhe individëve të cilët mund të kryejnë shërbime që lidhen me zbatimin apo mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Në kuadër të këtyre programeve prodhuesit vendosin kritere teknike, organizative për burimet njerëzore dhe për procedurat e brendshme të shoqërive. Këto programe/kushte ndërtohen nga vetë prodhuesit dhe ata në këtë mënyrë marrin përsipër cilësinë e shërbimeve të ofruara nga shoqëritë. Në shume raste, kalimi i çertifikimeve i kualifikon shoqëritë si të autorizuar prej tyre për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes, përmirësimit apo përditësimit të sistemeve të kamerave apo sistemeve të alarmit. Nëse shoqëritë nuk kanë punonjës të çertifikuar nga prodhuesit (për sisteme) çdo ndërhyrje në sistem rrezikon përfundimin e kushteve të garancise apo të mirëmbajtjes së prodhuesit.*

*Për këtë, çertifikimet e mësipërme që kanë lidhje me sistemet e kamerave dhe të alarmit që kërkohen si pjesë e integruar e shërbimit jo vetëm që përbëjnë një nevojë për garantimin e cilesisë së shërbimit, por ato janë direkt të lidhura edhe me kërkesat e prodhuesve për mirëmbajtjen. Ndërhyrjet në sistem nga punonjës të pa-çertifikuar mundet të dëmtojnë vetë sistemin, të dhënat që mbahen në sistem dhe/ose në kuadrin e sigurisë së informacionit apo të bëhen shkak për aksesin ose dëmtimin e informacionit nga/në persona apo drejtime të paautorizuara.*

*Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për tu garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve të nevojshme për realizimin e shërbimit dhe instalimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e sistemeve të kamerave dhe alarmit nga persona të autorizuar.*

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë për kamerat dhe sistemet e alarmit që do të vendosë në objekte duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilën nga pajisjet sipas modelit të deklaruar dhe specifikimeve përkatëse të përcaktuar në DST. (Katalogu duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli referuar specifikimeve teknike me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse plotësohen kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të paraqitur në katalog do të krahasohen me specifikimet teknike të kërkuara në DST për përputhshmërinë e tyre).

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar*

*përmbushjen e specifikimeve teknike të kamerave dhe sistemeve të alarmit të cilat janë të domosdoshme për realizimin e shërbimit objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me produkte të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre në realizimin e shërbimit pasi përdoren në objekte të cilat përgjithësisht frekuentohen nga një numër i madh qytetarësh dhe për pasojë duhet të krijohet një nivel i lartë sigurie.*

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesi një deklaratë nëpërmjet të cilës merr përsipër që pajisjet e kërkuara sipas DST do të integrohen në platformën monitoruese në sallën e AK.

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Kriteri është vendosur pasi është domosdoshmëri integrimi i sistemit të kamerave dhe alarmit me platformën monitoruese të autoritetit kontraktor nga ku monitorohen të gjitha objektet për parandalimin e ngjarjeve dhe problematikave që mund të dalin gjatë shërbimit të ruajtjes me roje.*

**2.3.10** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të lëshojnë deklaratë nëpërmjet të cilës merr përsipër montimin, instalimin, konfigurimin, testimin për pajisjet, si dhe të marrë përsipër të plotësojë planet e sigurisë për secilin objekt si dhe ti dorëzojë pranë rajonit të policisë përkatës.

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.*

**2.3.11** Operatori Ekonomik që do të realizojë shërbimin duhet të disponojë të paktën 1 (një) mjet shoqëruar me dokumentacionin sa më poshtë:

*Në rastin e automjetit në pronësi dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, Certifikatën e pronësisë, taksat vjetore dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), si dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumentin që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme), taksat vjetore dhe Certifikatën e pronësisë, të shoqëruara me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i ketij prokurimi.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/1 gërma c), neni 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 41 pika 4 gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.*

*Gjithashtu në bazë të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe udhëzimit të brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018, për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, për kryerjen me eficence të shërbimit, mjetet e shërbimit janë si një domosdoshmëri për ndërhyrje në mënyrë urgjente në rast ngjarje për ti ardhur në ndihmë rojes së sigurisë dhe objektit që ai ruan nga grupet e gatshme të shoqërisë.*

**2.3.12** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë autorizim individual në emër të tij për ngritje dhe shfrytëzim sistemi të pavarur radiokomunikacioni, Alarmi, lëshuar nga AKEP, ku të mbulohet zona ku kryhet shërbimi.

**Argumentimi:** *Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, e ndryshuar, Neni 41 pika 4 gërma a, si dhe të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 77.*

*Gjithashtu përcaktimi i këtij kriteri është bazuar në llojin e shërbimit, policitë private kanë detyrimin ligjor për të qenë të licencuar nga AKEP për të pasur një sistem radiokomunikimi të pavarur, për të garantuar një komunikim me një nivel të lartë sigurie, për shkak të informacionit sensitiv që mund të transmetohet mes tyre.*

**2.3.13** Operatorët ekonomik duhet te disponojnë qendër kontrolli në Qarkun Tiranë.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin në sistemin elektronik Akt Miratim të lëshuar nga DVP Tiranë sipas ligjit në fuqi.

**Argumentimi:** *Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, e ndryshuar, Neni 41, si dhe të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 77.*

*Gjithashtu bazuar në ligjin 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, çdo shoqëri private e sigurisë fizike ka detyrimin ligjor të jetë e pajisur me një qendër kontrolli, për të bërë kordinimin e çdo objekti në ruajtje.*

**2.3.14** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim performance të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, lëshuar jo me parë se 3 (tre) muaj nga data e hapjes së ofertave, ku te jepet informacion që subjekti nuk ka masa administrative, për titullarin e subjektit, drejtuesin teknik, për sallën operative, vërtetimi duhet të ketë opinion pozitiv për shoqërinë.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 41, pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 75/2014, datë 10.07.2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, të ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.*

**2.3.15** Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese në tender analizën e kostos për ofertën e paraqitur, e cila do të njihet e vlefshme vetëm me dy shifra pas presjes dhjetore.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar me qëllim respektimin e ligjshmërisë në përlllogaritjen e çmimit te kontratës dhe moslejimin e ofertave financiare të papërgjegjshme të cilat nuk garantojnë zbatimin me sukses te kontrates.*

**Argumentimi për mosndarjen në lote:**

Procedura nuk ndahet ne lote, pasi nuk eshte e nevojshme, procedura e hapur pa lote eshte bazuar ne udhezimet si dhe ne legjislacionin ne fuqi.

Nuk është rasti kur kontrata ndahet në lote, nuk përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, nuk është rasi që vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato.

**Argumentimi i specifikimeve teknike**

Referuar shërbimit që kërkohet të kryhet, atij të ruajtjes me roje private dhe monitorimit në distancë, bazuar në termat e referencës dhe specifikimet teknike të hartuara nga Grupi i punës për Përcaktimin e fondit limit, duke qënë se ato, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për shërbimin objekt prokurimi.

**Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”,

i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**